



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.19, datë 25. 03. 2021

“PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË BONUSIT TË QERASË SË BANESËS FAMILJES SYRJA SHKËMBI, NGA FSHATI LIQETH, NJËSIA ADMINISTRATIVE QËNDËR, BASHKIA SKRAPAR”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 25.03.2021, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 29, “Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike”, pika 1, të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30, pika f, në zbatim të VKM- së Nr.329, datë 16.05.2012, kreu III, pika 3, shkronja “dh”, si dhe vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.68 datë 24.12.2020 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe buxhetit të vitit 2021 për Bashkinë Skrapar dhe institucionet ne varësi të saj”

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit të qirasë së banesës 2+1, ndodhur në lagjen “5 Shtatori”, Çorovodë, për strehimin e familjes të Z.Syrja Shkëmbi nga fshati Liqeth, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Skrapar, për periudhën Mars - Dhjetor 2021.

Nr	Emër Mbiemër	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
1	Syrja Shkëmbi	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	50.000 Lekë
2	Totali											50.000 Lekë

2. Vlera prej 55.000 Lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602, zëri shpenzime operative administrata, në programin buxhetor administrim, planifikim, menaxhim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 13 vota pro , 1 votë kundër, vota abstenim - s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

